



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1004/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit Faton Bajrami dhe Krenar Berisha, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Primat” SH.P.K me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokat K.B., kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2010/19, të datës 09.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.05.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2010/19, të datës 09.06.2021, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.2010/19, të datës 09.06.2021, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Primat” SH.P.K me seli në Prishtinë. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, është anuluar aktvendimi me nr.01.3.2.2/142/16 i datës 19.07.2019, i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, është obliguar e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit “Primat” SH.P.K me seli në Prishtinë, t’ia kthej detyrimet e paguara më tepër në emër të taksave doganore importuese në vlerë prej 1,293.27€ (një mijë, e dyqind e nëntëdhjetë e tre e njëzeteshtatë cent) të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore (DUD) me nr. R-921/21.01.2019, të

proceduar në Zyrën Doganore Hani i Elezit, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e pagesës së detyrimeve importuese doganore 21.01.2016 e deri në pagesën e plotë të kësaj shume, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Dogana e Kosovës, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë ta aprovon ankesën në tërësi si të bazuar në ligj, ndërsa aktgjykimin e atakuar A.nr.2010/19, të datës 09.06.2021 ta prishë si të pa bazuar në ligj, dhe ta refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pa bazuar në ligj, duke lënë në fuqi vendimin e kontestuar.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/142/16 i datës 19.07.2019 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, e cila duke vepruar në ri procedurë sipas aktgjykimit të kësaj gjykatë A.nr.603/16 i datës 26.04.2019 e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e subjektit në procedurë “Primat” SH.P.K me seli në Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimit DUD-it me nr. R-921/21.01.2016, të lëshuar nga Zyra Doganore Hani i Elezit me të cilin vendim paditësit i është kontestuar dhe rivlerësuar vlera e deklaruar e mallit për zhdoganim.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 26.08.2019, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/142/16 i datës 19.07.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit

e aprovon si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Me arsytim se nuk përbën shkak ligjor për rivlerësimin e mallit dhe caktimin e bazës së re doganore për paditësin, fakti që tek e paditura mund të jetë zhdoganuar mall i ngjashëm me mallin lëndor, me karakteristika të njëjta, shtet eksportues dhe të origjinës, por që ka vlerë më të lartë të transakcionit se vlera e deklaruar e subjektit në procedurë, sepse me dispozitën e nenit 31 par. 1 të KDAK-së nuk thuhet që vlera doganore e mallrave të importuar duhet të jetë e njëjtë me vlerën e mallrave të ngjashme të shitura në Kosovë, me një periudhë të afërt kohore, por aty shprehimisht përcaktohet se :” Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transakcionit, që paraqet çmimin e vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur sipas nevojës në përputhje me nenet 36 dhe 37”, Ndërsa në par.3 të nenit 33 të KDAK-së është përcaktuar se : “ Cmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshinë të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësin, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbush obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtë për drejt ose në mënyrë të tërthortë”. Gjykata në shkallë të parë ka vlerësuar se të gjitha dokumentet e paraqitura nga paditësi sic është pro fatura e mallit lëndor me nr. 0001 e datës 22.12.2015, në shumë prej 10,145.89 euro, fatura e blerjes së mallit me nr. 669160 e datës 18.01.2016 në vlerë prej 10,145.00 euro, dokumenti transportues i mallit CMR, deklarata eksportuese e datës 19.01.2016 të lëshuar nga shteti eksportues, ku është e shënuar edhe vlera e deklaruar e mallit prej 10,145.00 euro, pastaj paditësi ka paraqitur edhe urdhër pagesat bankare ndërkombëtare për eksportuesin të datës 23.12.2015 në vlerë prej 3,900.00 euro dhe të datës 18.01.2016 në vlerë prej 6,245.00 euro, e që kur mbledhen japin shumën e përgjithshme prej 10,145.00 euro, me përshkrimin bankar për të dy pagesat “ pagesë e pjesërishtme e faturës me nr. 0001” Andaj në bazë të konstatimeve të lartcekura gjykata vlerëson se këto dokumente janë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë

duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të dispozitave të nenit 81G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L-222 dhe nenit 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave LKA-së, Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, si dhe të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë nuk ka administruar prova për të vërtetuar gjendjen faktike për arsye se e paditura në aktvendimin e kontestuar ka dhënë sqarimet e nevojshme mbi bazën e të cilave ka ardhur deri tek rivlerësimi i mallit, përkatësisht aplikimit të nenit 35 të KDAK-së dhe si referencë ka përdorur mallra të ngjashme të importuar nga importues tjerë të cilët kanë importuar mallin e njejtë me karakteristika të njëjta si origjinë, kod tarifor, përshkrim të njejtë etj, por me vlerë më të lartë se vlera e paraqitur nga paditësi, si dhe e paditura me vendimin e saj e konsideruar se paditësi nuk ka prezantuar dokumentacion të mjaftueshëm me të cilat paditësi do të vërtetonte se vlera e paguar për mallin kontestues është reale, për faktin se paditësi nuk kishte prezantuar dokumentacionin e harmonizuar me të cilin do të provohej se vlera e mallit kontestues është vlerë reale e transaksionit. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Sepse nga provat materiale gjykata ka konstatuar se dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është i harmonizuar në kuptim të vlerës së mallit dhe përmbush kriteret ligjore për tu pranuar vlera e deklaruar sipas faturave përcjellëse të mallit, pasi që nga transaksionet bankare që dëshmojnë vlerën reale të paguar të mallit lëndor, malli lëndor duhet të vlerësohet sipas nenit 33 të KDAK, respektivisht sipas vlerës së transaksionit që praqet çmimin e vërtet të paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë. Gjykata ka konstatuar se dokumentacioni i prezantuar është i pakontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, konform nenit 33 par

1 të KDAK-së dhe në bazë të kësaj është detyruar e paditura që paditësit t'ia kthej shumën prej 1,293.97 euro të paguar më tepër për shkak të rivlerësimit të padrejtë të mallit, në emër të detyrimeve importuese, për mallin e zhdoganuar përmes DUD-it me nr. R-921/21.01.2016 të ZD Hani i Elezit dhe se shuma është nxjerrë nga dokumenti-akti i inspektimit të paditurës nga sistemi "ASYCUDA" i datës 03.08.2016. Andaj në kontekst të argumenteve ligjore dhe faktike dhe duke marr parasysh se e paditura Dogana e Kosovës edhe në procedurën e rivendosjes nuk i ka vërtetuar faktet esenciale ka nxjerr konkluzion jo të drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, nuk ka zbatuar drejt dispozitat e legjislacionit doganor. Gjithashtu gjykata në këtë konflikt administrativ posedon prova të mjaftueshme për të vendosur në mënyrë meritore këtë konflikt administrativ në pajtim me nenin 81.1 par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 nenit 43 par.3, 46 parag.4 të LKA-së.

Dhoma e Shkallës së dytë pati parasysh edhe pretendimet ankimore lidhur me kamatën ligjore për faktin se nuk është paraqitur si kërkesë akcesore në padi dhe në këtë mënyrë nuk janë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e nenit 258 të LPK-së, mirëpo gjeti se gjykata në shkallë të parë me të drejtë ka vendosur kur ka aplikuar dispozitat e nenit 292 pika b) (I), të KDAK-së, 170 të LMD-së dhe 382 të LMD-së, sepse pala paditëse e ka precizuar kërkespadinë sa i përket kamatës gjatë shqyrtimit kryesor edhe pse nuk ka qenë prezent e paditura mirëpo me parashtresën e datës 04.06.2021 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të marrë pjesë në seancë dhe e ka dhënë pëlqimin që seanca të mbahet në mungesë të saj.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një

aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1004/22, me datë 01.06.2023

**Kryetar i kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**